

L I G J
Nr.8471, datë 8.4.1999

**PËR NXJERRJEN E DETYRIMEVE DEBITORE DHE RIKTHIMIN E VLERAVE
PASUORE NË LLOGARITË E PERSONAVE JURIDIKË, JOBANKARË QË KANË
MARRË HUA NGA PUBLIKU I GJERË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ky ligj përcakton detyrimet e debitorëve të ndryshëm, fizikë a juridikë, vendas e të huaj, kundrejt subjekteve të kontrollit dhe personave të lidhur në kuptim të nenit 4 të ligjit nr.8227, datë 30.7.1997 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8215, datë 9.5.1997 “Për kontrollin financiar të personave juridikë, jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, si dhe përcakton kohën, mënyrën dhe vlerën e arkëtimit të detyrimeve debitoare dhe rikthimin e pasurive nga të tretët pranë administratorëve, me qëllim të shlyerjes sa më mirë të kreditorëve.

Neni 2

Me “debitorë”, sipas këtij ligji, konsiderohen grupet e mëposhtme:

2.1 Të gjithë personat fizikë e juridikë, vendas e të huaj, të cilët kanë ende detyrime të çfarëdo natyre të pashlyera kundrejt personave të parashikuar në nenin 1 të këtij ligji, që, sipas Kodit Civil, në çastin e përmbushjes së detyrimit i ka kaluar afati i përmbushjes së tyre dhe duhet t’i kthejnë ato pranë administratorit, për t’u përdorur prej tij, për të përmbushur detyrimet e shoqërive huamarrëse kundrejt kreditorëve të tyre.

2.2 Personat e lidhur, në kuptim të nenit 4 të ligjit 8227, datë 30.7.1997 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8215, datë 9.5.1997 “Për kontrollin financiar të personave juridikë, jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, për të gjitha llojet e pasurive të marra ose të përfituara në çfarëdolloj forme nga subjektet e kontrollit.

2.3 Personat fizikë a juridikë që pas datës 23.1.1997 kanë mbyllur kontratat e huadhënies dhe vlera financiare e tërhequr nga ana e tyre është mbi 1 milion lekë (10 mijë dollarë amerikanë të konvertuar).

Të gjithë personat që i nënshtrohen detyrimit ligjor të deklarimit të pasurisë sipas ligjit nr.7903, datë 8.3.1995, kthejnë çdo shumë të tërhequr pas datës 23.1.1997.

2.4 Si debitorë, në kuptim të këtij ligji, konsiderohen edhe personat e tjerë fizikë a juridikë, vendas e të huaj, që rezultojnë si të tillë në bazë të dispozitave ligjore në fuqi, por që nuk janë përfshirë në një nga grupet e mësipërme.

Neni 3

Të gjitha ato veprime juridike të kryera nga subjektet e kontrollit apo personat e lidhur me ta, me të tretë, që janë ose shpallen të pavlefshme nga gjykata, në bazë të neneve 92 dhe 94 të Kodit Civil, dhe në rast se si njëra palë apo tjetra kanë nxjerrë përfitime të pasurive prej tyre, ato janë të detyruara të kthejnë pranë administratorit shumat apo sendet e përfituara.

Neni 4

Identifikimi i pesonave fizikë e juridikë, vendas e të huaj, si dhe të detyrimeve pasurore që ata kanë, në kuptim të nenit 2 dhe 3 të këtij ligji, kryhet nga administratorët e caktuar në bazë të ligjit nr.8227, datë 30.7.1997 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8215, datë 9.5.1997 “Për kontrollin financiarë të personave juridikë jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Në procesin e identifikimit organet shtetërore detyrohen të venë në dispozicion të administratorit dokumentacionin që ata kanë për shoqëritë huamarrëse, me qëllim që nga ana e tyre të kryhen veprime konkrete për verifikimin e të dhënave që u nevojiten për kryerjen e procesit të transparencës.

Neni 5

Administratori, në përfundim të procesit të identifikimit, merr vendim për personat subjekt të këtij ligji, që shpallen debitorë, për vlerën financiare e pasurore që ata duhet të kthejnë në llogarinë e shoqërisë huamarrëse, për shlyerje të kreditorëve. Ky vendim përbën titull ekzekutiv.

Neni 6

Publikimi i personave fizikë e juridikë, vendas e të huaj, që kanë rezultuar të tillë sipas nenit 5 të këtij ligji, bëhet nga administratori në dy gazeta me qarkullim kombëtar, në mjetet elektronike të informimit publik dhe me shpalljen e tyre pranë selive të subjekteve të kontrollit.

Publikimi ka efekt, në kuptim të këtij ligji, 3 ditë pas publikimit të parë.

Neni 7

Personat, të cilët janë publikuar nga administratori sipas këtij ligji, duhet të përmbushin vullnetarisht detyrimet kundrejt subjektit të kontrollit, brenda 45 ditëve nga data e njoftimit të detyrimit debitor.

Neni 8

Në rastin kur personat fizikë e juridikë, vendas e të huaj, të shpallur debitorë, nuk e ekzekutojnë vullnetarisht detyrimin, administratori i paraqet zyrës së përmbarimit në juridiksionin e së cilës ka vendbanimin ose selinë debitori, ose zyrës së përmbarimit ku ndodhet sendi, kërkesën për ekzekutimin e detyrueshëm të detyrimit.

Në përputhje me nenet 609 dhe 610 të Kodit të Procedurës Civile, debitori, ndaj vendimit të administratorit dhe veprimeve të përmbaruesit, ka të drejtë, që brenda 10 ditëve ndaj vendimit të administratorit dhe brenda 5 ditëve ndaj veprimeve të përmbaruesit, të bëjë ankim kundër tyre në gjykatën e apelit.

Gjykata e apelit i shqyrton ato brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës.

Zyra e përmbarimit për ekzekutimin e vendimit të administratorit, zbaton të gjitha rregullat e Kodit të Procedurës Civile dhe vendos sekuestro mbi pasurinë e debitorit, në atë masë sa është vlera e detyrimit ose mbi sendin objekt detyrimi.

Neni 9

Mjetet monetare të nxjerra me përfundimin e procedurës së ekzekutimit të detyrueshëm, derdhen në emër të administratorit dhe për llogari të shoqërisë huamarrëse të shpallur në administrim për shlyerjen e kreditorëve.

Pasuritë e vëna në sekuestro vihen në shitje nga administratori i shoqërisë huamarrëse sipas dispozitave të përcaktuara në ligjin “Për mënyrën dhe procedurën e shitjes së pasurive të pesonave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”.

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2351, datë 16.4.1999 të Presidentit të Republikës të Shqipërisë,
Rexhep Meidani**